

UDHËZIM
Nr. 4, datë 27.4.2022

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR
DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURËN E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS PËR
PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 20, pika 6, të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”,

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shqyrtimit të kërkesës për pezullimin e përkohshëm të ushtrimit të profesionit të përkthyesit zyrtar dhe interpretit të gjuhës së shenjave.

2. Kur përkthyesi zyrtar ose interpreti i gjuhës së shenjave çmon se përmbushet një nga kushtet e parashikuara në nenin 20, pika 1, të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, i paraqet kërkesë të arsyetuar ministrit të Drejtësisë për pezullimin e përkohshëm të ushtrimit të profesionit.

3. Kërkesa e arsyetuar mund të depozitohet përmes shërbimit postar, adresës zyrtare të postës elektronike ose edhe dorazi në protokollin e Ministrisë së Drejtësisë.

4. Kërkesa e arsyetuar përmban shkakun e pezullimit, sipas shkaqeve të përcaktuara në nenin 20, pika 1, të ligjit, kohëzgjatjen e periudhës së pezullimit, si dhe shoqërohet nga dokumentacioni përkatës vërtetues i shkakut për të cilat kërkohet pezullimi i ushtrimit të profesionit, sipas pikës 6 të këtij udhëzimi.

5. Dokumentacioni vërtetues i shkakut për të cilën kërkohet pezullimi është si vijon:

a) kur pezullimi i ushtrimit të profesionit kërkohet për shkaqe shëndetësore, sipas parashikimit të neni 20, pika 1, shkronja “a”, përkthyesi zyrtar duhet të depozitojë një raport mjekoligjor, si dhe çdo dokument tjetër shëndetësor që provon pamundësinë e ushtrimit të profesionit për shkaqe shëndetësore, sipas legjislacionit në fuqi;

b) kur pezullimi i ushtrimit të profesionit kërkohet për shkak të përkujdesjes për një fëmijë të mitur, sipas parashikimit të neni 20, pika 1, shkronja “b”, përkthyesi zyrtar duhet të depozitojë certifikatën e lindjes së fëmijës;

c) kur pezullimi i ushtrimit të profesionit kërkohet për shkak të zgjedhjes ose emërimit në një funksion publik, sipas parashikimit të neni 20, pika 1, shkronja “c”, përkthyesi zyrtar duhet të depozitojë aktin e emërimit, aktin e zgjedhjes, kontratën e punës ose çdo akt tjetër, sipas parashikimit të legjislacionit në fuqi, që provon zgjedhjen ose emërimin në një funksion publik ose fillimin e ushtrimit të një detyre tjetër që është e papajtueshme me ushtrimin e profesionit të përkthyesit zyrtar.

6. Në rastet kur Ministria e Drejtësisë konstaton mangësi në dokumentacionin shoqërues të kërkesës, të përcaktuar sipas pikave 4 dhe 5 të këtij udhëzimi, përkthyesit zyrtar apo interpretit të gjuhës së shenjave i kërkohet që, brenda 5 (pesë) ditëve nga çasti i marrjes së njoftimit, të bëjë plotësimin e dokumentacionit të kërkuar. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kritereve, nuk është i plotë, i saktë ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Drejtësisë mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga çdo organ publik apo persona të tjerë juridikë, vendas ose të huaj. Në këtë rast, afatet e shqyrtimit të kërkesës pezullohen deri në momentin e plotësimit të dokumentacionit.

7. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga administrimi i kërkesës, nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, ministri i Drejtësisë vendos mbi miratimin ose refuzimin e argumentuar të kërkesës për pezullimin e përkohshëm të ushtrimit të profesionit të përkthyesit zyrtar/interpretit të gjuhës së shenjave.

8. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, përkthyesit zyrtarë dhe interpretët e gjuhës së shenjave për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

9. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e masave të nevojshme për njoftimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja